

PAKETA 2026-2040

PAKETA 4 MILIARDE EURO

INICIATIVA E PROPOZUAR	IMPAKTI FINANCIAR VJETOR	KOMENTE MBI INICIATIVEN
Bonusi i lindjes: Femija i pare – 1mije euro, Femija i dyte – 2 mije euro, Femija i trete – 3 mije euro, Femija i katert e me shume – 5 mije euro.	60.000.000 euro	Duke parashikuar 30 mije lindje ne vit, me nje rritje te ndjeshme nga rreth 22 mije qe jane aktualisht.
Bonusi mujor per femijet: (lindur 2026 vazhdim) 50 euro per cdo femije deri ne moshen 6 vjecare. 60 euro per cdo femije ne moshen 6-18 vjecare.	15.000.000 euro vitin e pare (30 mije lindje).	Vlere e cila rritet ne progresion arithmetik vit pas viti.
Pagese zero per femijet e trete apo me shume per cerdhe/kopesht publik.	5.000.000 euro	Te pakten 15mije femije cdo vit.
Rimbursim te ilaceve per femijen e trete apo me shume, por jo me shume se 120 euro ne vit.	1.000.000 euro	Te pakten 8 mije femije cdo vit.
Leje lindje me pagese te plote per 365 dite	80.000.000 euro	Te pakten 30 mije nena cdo vit.
TAP mbi pagen: Nenat me 3 femije perjashtohen nga TAP. Baballaret me 4 femije perjashtohen nga TAP.	25.000.000 euro	
Te rinjte deri ne moshen 25 vjec te perjashtuar nga pagesa e TAP mbi pagen.	10.000.000 euro	200 mije te rinj perfitues.
Kredi te bute, interesat kreditore te subvencionuara nga buxheti i shtetit per 5 mije cifte te reja cdo vit (kredi deri ne 100 mije euro).	15.000.000 euro	Te pakten 5 mije cifte te reja, per kredi deri ne 100 mije euro.
Bonus rindertimi (shtepi ekzistuese) ciftet e reja: 10 mije euro per banesat ne zonat urbane. 8 mije euro per banesat ne zonat rurale.	10.000.000 euro	1000-1200 perfitues cdo vit (ne varesi te vendndodhjes).

Subvencionim deri ne masen 1/3 e vleres shtese qe familja duhet te paguaje per banese me te madhe si pasoje e shtimit te numrit te personave ne familje (lindjet e reja), por jo me shume se 30 mije euro.	15.000.000 euro	Te pakten 500 perfitues cdo vit.
Zero takse mbi token bujqesore me kushtin qe ajo te punohet.	1.000.000 euro	20 mije HA.
Pergjysmim te TAP dhe pergjysmin per cdo takse/tatim/tarife qendrore dhe vendore per ata qe punojne token.	5.000.000 euro	
Per ata qe rikthehen (migrim i brendshem apo nga jashte) te jetojne e punojne token ne fshat, zero taksa/tatime/tarifa per tre vitet e para.	10.000.000 euro	
Linjat e prodhimit: financim 50% te cdo linje prodhimi, por jo me shume se 30 mije euro per cdo linje. Per ata qe vijne nga migrimi: financim 70%, jo me shume se 40 mije euro per cdo linje prodhimi.	8.000.000 euro	Te pakten 200 linja prodhimi cdo vit.
Pergjysmim te cdo takse/tatimi/tarife per grate sipermarrese qe do hapin biznes ne nje prej tre qarqeve me te varfera, apo qe punesojne te pakten 50% gra ne sipermarrjen e tyre (fsh fasoneri, ferme, baxho, etj).	5.000.000 euro	Mbeshtetje per te pakten 250 sipermarrje ne pronesi te grave.
Toke publike falas per ndertime per strehim. Toke publike me 1 euro per 99 vjet per qellime biznesi (psh baxho, stalla, etj)	-	
IMPAKTI I PERAFERT VJETOR	265 MLN EURO	
IMPAKTI I PERAFERT 2026-2040	4 MLD EURO	